



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	24-10-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPMSHCK	6413/2022		1/9



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.225/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1474/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 12.09.2022, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.225/2020 të datës 10.08.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.225/2020 të datës 10.08.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas Kontratës së marrëdhënies së punës të datës 28.06.2018 i punësuar në pozitën Drejtorit i Shkollës në SHMP “Adem Gllavica” në Komunën e Lipjanit, me datë 08.07.2020 ka parashtruar kërkesë pranë Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Lipjanit duke kërkuar kompensimin e pagave shtesë në emër të kualifikimit -Master.

Për shkak të heshtjes, ka parashtruar ankesë në Komisionin Komunal për Ankesa në Komunën e Lipjanit me datë 24.07.2020 duke kërkuar që të realizoj pagesën shtesë në emër të kualifikimit MR-DR dhe atë në shumën prej 21.84 euro për muaj që nga momenti i njohjes së kësaj të drejte me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi pagesat e rikualifikimeve sipas gradës për Drejtor, Mësimdhënës dhe Bashkëpunëtor Profesional, nr. 01/33 të datës 29.08.2008.

Ankuesi, për shkak të heshtjes së Komisionit Komunal për Ankesa në Komunën e Lipjanit parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 10.08.2020 dhe numër protokollit 1505/2020 e regjistruar me numër A.nr.225/2020, për realizimin e të drejtës në kompensim material sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi pagesat e rikalifikimeve sipas gradës për Drejtor, Mësimdhënës dhe Bashkëpunëtor Profesional nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.08.2020, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Lipjanit. Ndërsa Këshilli me datë 01.05.2020 ka pranua nga Komuna e Lipjanit, përgjigjen në kërkesë me numër protokollit: 1666/2020, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në kohën e parashtrimit të ankesës nga ankuesja ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 03.09.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 12.09.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1474/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 03.09.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 10.08.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1505/2020 të datës 10.08.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa me nr.prot.4-120-31066 e datës 24.07.2020 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin Komunal për Ankesa në Komunën e Lipjanit; Kërkesa me nr.prot.4-153-28074 e datës 08.07.2020 drejtuar Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Lipjanit; Kopja e letërnjoftimit; Kontrata e marrëdhënies së Punës nr.112-39620 e datës 28.06.2018; Diplomë e lëshuar nga BprAL Kolegji ISPE për H.S nr. D-17/15 e datës 03.11.2015; Lista e pagave për periudhën kohore 01.06.2020 deri 30.06.2020, me shkresën e bashkangjitur (nr.20200706174828095.pdf- përmbajtja tjetër e padukshme); Kërkesa për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1530/2020 e datës 13.08.2020; Përgjigja në ankesë me numër të protokollit 1666/2020 e datës 01.05.2020; Formulari i vlerësimit individual/Kriteret e zgjedhjes së ngushtë e datës 23.07.20019; Konkursi i brendshëm MD/DMLPPL/11-07-01-2019, 1-3 faqe; Regjistri i kërkesave të pranuar sipas librit të pranimit i lëshuar nga Ministria e drejtësisë/Departamenti për financa dhe shërbime të përgjithshme; Autorizim për publikim e konkursit i lëshuar nga Ministria e Administratës Publike- Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil i datës 08.07.2019; Pliko e bardhë nr. R9148609 e datës 28.08.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.225/2020 të datës 10.08.2022, të parashtruar nga ankuesi: *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të prova të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi në bazë të Kontratës së Punës nr.112-39620 të datës 28.06.2018 është zgjedhur Drejtorit i Shkollës në SHMP "Adem Gllavica" në Komunën e Lipjanit.

Kolegji i Këshillit lidhur me kompetencën lëndore të Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3 Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, përkatësisht neni 2 paragrafi 4 i të njëjtit ligj ka përcaktuar se: Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike", dhe si rrjedhojë duke u bazuar edhe në përshkrimin e detyrave të punës të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pozita "Drejtor i Shkollës" hynë në kategorinë e nëpunësve të Shërbimit Publik, respektivisht ankuesi sipas pozitës që mbanë nuk e ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.*

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.225/2020 të datës 10.08.2020 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafi 4 ndër lidhur me nenin 2 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike fillimisht të Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publikë dhe Nëpunësit Tekniko - Administrativ pranë punëdhënësit dhe më pas mund të mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.225/2020

Flakron Gashi


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

